

KURS TRAJNIMI

MENAXHIMI FINANCIAR PËR MENAXHERËT JO-FINANCIERË

Përshkrimi i kursit

Menaxhimi financiar është jetik për menaxhimin e përgjithshëm të shoqërive ujësjellës kanalizime. Vendimet të cilat merren pa kuptuar mirë pasojat financiare mund të çenojnë performancën e shoqërisë. Ky kurs trajnimi ka si qëllim ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve për rolin e menaxhimit financiar.

Kursi do të trajtojë çështje të cilat kanë të bëjnë me ciklin, rolet dhe mjetet e menaxhimit financiar, kontabilitetin, kostot e shërbimit, vendosjen e tarifave si dhe planifikimin e kapitalit.

Pjesëmarrësit do të pajisen me njohuri dhe aftësi të nevojshme për të përdorur informacionin financiar për të marrë vendime më të mira afatshkurtëra dhe afatgjata.



Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për menaxherët, drejtorët e drejtorive dhe për çdo punojës të interesuar për të marrë njohuri thelbësore financiare.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi ju do të jeni të aftë të:

- Kuptoni rolin e menaxherit financiar dhe individëve të tjerë në shoqëri të përfshirë në menaxhimin financiar;

- Përdorni raportet financiare për të analizuar performancën e shoqërisë;
- Identifikoni instrumentet e menaxhimit financiar që mund të përdoren në një shoqëri;
- Përcaktoni kërkesën e të ardhurave për një shoqëri;
- Identifikoni shpenzimet operationale dhe ato të mirëmbajtjes;
- Kuptoni parimet e Entit Rregullator të Ujit në përcaktimin e tarifave;
- Analizoni një strukturë tarife;
- Identifikoni shpenzimet kapitale;
- Analizoni faktorët që ndikojnë në planifikimin e kapitalit;
- Analizoni projektet kapitale;
- Përcaktoni përfitimet financiare dhe jo-financiare të çdo projekti;
- Analizoni kostot dhe përfitimet e çdo projekti.

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë edhe raste konkrete studimore.

Materialet e kursit

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit "Menaxhimi Financiar për Menaxherët Jo-Financierë". Përpos kësaj, ju do të pajiseni me certifikatë e cila dëshmon pjesëmarrjen tuaj në këtë trajnim.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB dhe SHUKOS: 22,000 lekë ose 164 Euro për person.

Jo-anëtarët: 25,000 lekë për person.

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.

KURS TRAJNIMI MENAXHIMI FINANCIAR PËR MENAXHERËT JO-FINANCIERË

FORMULAR REGJISTRIMI

Emër Mbiemër _____

Datëlindja _____

Institucioni _____

Pozicioni _____

Edukimi _____

Celular _____

E-mail _____

Ju lutem, plotësoni këtë formular dhe dërgojeni në adresën e e-mailit training@shukalb.al ose shukos2001@gmail.com brenda datës 11 dhjetor.
Pagesën mund ta derdhni në llogarinë bankare të SHUKALB si më poshtë, duke specifikuar emrin tuaj dhe qëllimin e transfertës:

Banka: PROCREDIT, Dega Tiranë
Emri i Llogarisë: Shoqata e Ndërmarrjeve Ujësjiellës Kanalizime të Shqipërisë
Numri i Llogarisë: 10-831379-00-01
IBAN: AL 95209111080000108313790001

***Shënim:** Pjesëmarrja juaj në këtë aktivitet duhet të konfirmohet nëpërmjet e-mailit, telefonit apo postës.*